



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria -Vlada-Government*

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Ministarstvo  
Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja - Ministry of Agriculture,  
Forestry and Rural Development

Në mbështetje të nenit 145 paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 1.3 (d) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 të datës 13 shtator 2001 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, neni 3 paragrafi 1, dhe neni 57 Ligji Nr.03/L-042 i produkteve për mbrojtjen e bimëve, dt. 7 nëntor 2008, Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,

Miraton:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 09/2009**  
**Autorizimi për Certifikim të Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

1. Me këtë Udhëzim Administrativ përcaktohet autorizimi për certifikim të produkteve për mbrojtjen e bimëve që përmbajnë substanca aktive për qëllime fitosanitare në territorin e Republikës së Kosovës.
2. Ky udhëzim administrativ përcakton kushtet për autorizim të personave fizik dhe juridik që merren me importim, tregtim të produkteve për mbrojtjen e bimëve.

**Neni 2**  
**Përkufizimet**

Termet dhe shprehjet e përdorura në këtë udhëzim administrativ kanë këtë kuptim:

“**Produkte për Mbrojtjen e Bimëve - PMB**” – nënkupton formën përfundimtare të produkteve për mbrojtjen e bimëve të substancave aktive dhe preparateve të cilat përdoren për mbrojtjen e bimëve nga organizmat e dëmshëm;

“**Komiteti vlerësues**” - përcakton vlerësimin e efikasitetit të produkteve për mbrojtjen e bimëve përkatësisht substancave aktive, vetive toksikologjike, metabolike, ekotoksikologjike dhe mënyrën e veprimit të substancave aktive që përdoren në mjedis në bazë të provave dhe testimit të tyre;

“**Komiteti autorizues**” - përcakton vlerësimin e PMB dhe substancave aktive për autorizim ose shtynë procedurën e autorizimit për certifikim;

“**Autorizimi**” – nënkupton procesin e lejuar me të cilin organi kompetent i Ministrisë e autorizon personin fizik apo juridik me certifikatë të regjistrimit për vendosjen në treg për qarkullim të PMB brenda territorit të Republikës së Kosovës;

“**Certifikatë**” – nënkupton dokumentin e nënshkruar nga organi kompetent për PMB;

“**Ministria**” nënkupton Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;

“**Organ kompetent**” – nënkupton Departamentin e Prodhimit dhe Mbrojtjes së Bimëve;

“**Person**” – nënkupton personin fizik dhe juridik.

### **Neni 3 Aplikimi**

Personat fizik dhe juridik që aplikojnë për tu pajisur me autorizim për certifikim të produkteve për mbrojtjen e bimëve, duhet të plotësojnë formularin Nr.01/2009 i cili merret dhe pas plotësimit dorëzohet në organin kompetent të Ministrisë.

### **Neni 4**

1. Pas pranimit të aplikacionit për autorizim të Produkteve për mbrojtjen e bimëve, organi kompetent merr vendim për dhënien apo refuzimin e autorizimit duke u bazuar në bazë të vlerësimit të substancave aktive të PMB-ve.

2. Kur një PMB i plotëson kushtet nga paragrafi 1 i këtij neni, lejohet numri i autorizimit për importim, tregtim të tij, dhe në formë të shkruar njoftohet Kompania prodhuese ose përfaqësuesi i sajë legjitim.

3. Në rastet kur nuk janë plotësuar kushtet nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni, Komisioni për autorizim, vendos për mos dhënien e autorizimit për PMB nëse:

1.1 substancat aktive janë tërheq nga Lisat e Direktivës Nr.91/414 EEC;

1.2 shkel dispozitat e këtij udhëzimi administrativ dhe

1.3 ekzistojnë të dhëna paraprake nga inspektori fitosanitar se aplikuesi paraprakisht para se të jetë certifikuar i ka vendos ato në treg.

### **Neni 5**

1. Personat nga neni 3 i këtij udhëzimi administrativ nuk kanë të drejtë të importojnë, vendos në tregun e Kosovës PMB pa autorizim paraprak të lëshuar nga organi kompetent.

2. Përbashimisht nga paragrafi 1 i këtij neni për qëllime hulumtuese shkencore mund të behët rishikimi i PMB të autorizuar në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe Direktivën e Komisionit Evropian Nr. 91/414 EEC.

### **Neni 6**

1. Organi kompetent nga neni 3 i këtij udhëzimi administrativ i propozon Ministrisë për nxjerrjen e vendimit për dhënien e autorizimit për importim dhe tregtimin të PMB.

2. Autorizimi nga paragrafi 1 i këtij neni lëshohet në formë të certifikatës, i nënshkruar dhe i pajisur me numër të caktuar.

### **Neni 7**

#### **Taksat**

1. Personat fizik dhe juridik për tu pajisur me autorizim për PMB duhet ta paguajnë taksat sa vijon:

1.1 për autorizim .....500€

1.2 leje të veçantë .....200€

1.3 leje të importit .....100€

1.4 leje për shqyrtim vetanak .....80€

1.5 leje për hulumtim shkencore .....30€

1.6 leje për persona përgjegjës .....20€

### **Neni 8**

Të gjitha të hyrat që rrjedhin nga zbatimi i këtij udhëzimi administrativ derdhën në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

### **Neni 9**

Pjesë përbërëse e këtij udhëzimi administrativ është formulari Nr.01/2009.

### **Neni 10**

Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi administrativ shfuqizohet:

1. Udhëzimi Administrativ Nr. MA-15/2004 për caktimin e kushteve të veçanta për prodhim, importim, eksportim, plasim në treg dha aplikim profesional të pesticideve, dt. 18.11.2004,
2. Udhëzimi Administrativ MA-NR.21/05 për regjistrimin administrativ të emrit komercial të pesticideve që përmbajnë substanca aktive të lejuara për vendosje në treg, qarkullim dhe përdorim të tyre në Kosovë, dt. 25.11.2005

### **Neni 11**

#### **Hyrja në fuqi**

Ky Udhëzim Administrativ hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, më 28.04.2009

Ministri i Ministrisë së Bujqësisë,  
Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

---

Idriz Vehapi